



KOMUNIKATË

10. 10. 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka mbajtur sot mbledhjen e 40-të të këtij viti, në të cilën mbledhje ka analizuar dhe shqyrtuar një varg detyrash të lidhura me procesin zgjedhor. Kryetarja e KQZ-së, znj.Nesrin Lushta në fillim të mbledhjes ka kërkuar miratimin e rendit të ditës dhe pastaj, aprovimin e raporteve 31,32,34,35 dhe 36/2009 nga mbledhjet e kaluara. Anëtarët e KQZ-së, kanë miratuar rendin e ditës dhe raportet nga mbledhjet e kaluara.

Në vazhdim të mbledhjes, është shqyrtuar Draft-Projekti për Votuesit e Verbër. Kryeshefi i SKQZ-së, z. Xhemajl Peqani, ka dhënë shpjegimet e nevojshme lidhur me këtë projekt që është donacion i Ambasades Gjermane. Ky projekt, bëhet me qëllim që të lehtësohet mundësia e personave të verbër dhe personat me të pamur të dobësuar, për të votuar në zgjedhje. Projekti në fjalë, kap shumën prej 46050 euro, dhe do t'u mundësoj 5000 votuesëve të natyrës së këtyllë të votojnë në zgjedhjet e 15 nëntorit. KQZ, e ka miratuar këtë projekt, duke e falenderuar donatorin për ndihmën e dhënë.

Anëtarët e KQZ-së, kanë shqyrtuar edhe Formularin e Njoftimit për Mbajtjen e Tubimeve Politike. Sipas formularit të përcaktuar, Subjektet Politike do të organizojnë dhe mbajn tubimet e tyre gjatë kohës së fushatës elektorale. Formulari, përfshinë të dhënat lidhur me datën dhe kohën e dorëzimit të zyrta ekzekutiv, përfshinë pastaj emrin dhe mbiemrin e personit që e dorëzon, informacionet lidhur me tubimin etj. Anëtarët e KQZ-së e kanë aprovuar formularin me pak ndryshime.

Në vazhdim të mbledhjes së sotshme, gjithashtu është shqyrtuar edhe Draft-Projekti për Qendren Mediale. Qendra Mediale, do të shërbejë të shpërndaj informacione për publikun, për mediat dhe opinionin e gjërë të interesuar lidhur me rrjedhën e procesit zgjedhor. Qendra Mediale, gjithashtu është një donacion i Ambasades Gjermane në vlerë prej 40510 euro.

KQZ ka shqyrtuar edhe Doracakun pwr procedurat për votimin e personave me nevoja të veqanta. Llojet e votimit të këtillë, kanë të bëjnë me votuesit e ngujuar në shtëpi, votuesit nëpër institucione të veqanta dhe votuesit në rrethana të veqanta.

Në mbledhjen e sotshme, KQZ ka shqyrtuar edhe emrimet e grupit të IV-t të Këshillave të Vendvotimeve. Në takimin e sotshëm, janë miratuar Këshillat për komunat e Shtërpces, të Klllokotit, të Prizrenit, të Zveqanit dhe të Ranillugut. Ndërkaq, emrimi për Këshillat e Vendvotimeve për Komunën e Prishtinës, sështë shtyrë për në mbledhje tjetër të ardhshme.

Poashtu, anëtarët e KQZ-së, kanë aprovuar rekomandimet e ZRPP-së për tërheqjen nga lista të dy kandidatëve për arsye të caktuara. Në fund të kësaj mbledhje në diskutimet e ndryshme, kryetarja Nesrin Lushta, ka njoftuar se më 14 tetor, një ditë para fillimit të fushatës zgjedhore KQZ do të organizoj një pritje me përfaqësuesit e Shtabeve Zgjedhore, të Ambasadave të akredituara në Prishtinë, si dhe me përfaqësues të mediave.